



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOLEGJI ZGJEDHOR GJYQËSOR
TIRANË

Nr.5 Regj.Them.
Datë Rregj. 02.04.2021

Nr.6 VENDIMI
Datë 08.04.2021

V E N D I M
“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, i përbërë nga:

Gjyqtar: Gentian MEDJA (*Relator*)
Gjyqtare: Manjola XHAXHO (*Anëtare*)
Gjyqtare: Emona MUÇI (*Anëtare*)
Gjyqtare: Edlira PETRI (*Anëtare*)
Gjyqtare: Esmeralda ÇEKA (XHILI) (*Anëtare*)

asistuar nga sekretare gjyqësore Erjona Torba, më datë 08.04.2021, në seancë gjyqësore me dyer të hapura, mori në shqyrtim çështjen me nr.5 akti, dat 02.04.2021 që i përket:

PADITËS: Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës – Konservatorët (ABEOK), përfaqësuar në gjykim nga Av. Shpëtim Kodhelaj.

IPADITUR: Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve), përfaqësuar në gjykim nga Erdal Mema dhe Shila Ballhysa.

OBJEKTI:

1. Ndryshimin e Vendimit Nr.13, datë 30.03.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) dhe ndryshimin e Vendimit Nr.172, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do tu shpërndahen si paradhënie partive politike në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.
2. Pranimin e ankimit, detyrimin e Komisionerit Shtetëror të

Zgjedhjeve të financojë, për caktimin e sasisë së fondit nga Buxheti Shtetëror në shpërndarjen e partive politike të Koalicionin ABEOK pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

BAZA LIGJORE: Nenet 442/a, 452-454 ,466/b të KPC, nenet 145/1,152/1 të Ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, i përditësuar.

Në përfundim të gjykimit, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor pasi dëgjoi pretendimet e fundit të palës paditëse që kërkoi pranimin e padisë sipas objektit, dëgjoi pretendimet e fundit të paditur që kërkoi rrëzimin e padisë, si dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN

1. Se pala paditëse, Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës - Konservatorët (ABEOK), më datë 02.04.2021 i është drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me kërkesëpadi duke kërkuar ndryshimin e vendimit Nr.172, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do tu shpërndahen si paradhënie partive politike në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”, ndryshimin e vendimit Nr.13, datë 30.03.2021 të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve (KAS) dhe detyrimin e KSHZ të financojë, për caktimin e sasisë së fondit nga Buxheti Shtetëror në shpërndarjen e partive politike të Koalicionin ABEOK pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

FAKTET E ÇËSHTJES

2. Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr.11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

3. Me vendimin nr.117, datë 08.03.2021, të KSHZ-së, Koalicioni “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës - Konservatorët” (ABEOK) në zbatim të neneve 65 dhe 66 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021.

4. Koalicioni “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës – Konservatorët” (ABEOK), si subjekt zgjedhor, ka në përbërje të tij Partinë Kombëtare Konservatore Albania,

Partinë Ora e Shqipërisë, Partinë Emigracioni Shqiptar dhe Partinë Bashkimi Popullor i Pensionistëve Shqiptar.

5. Koalicioni ABEOK, në zbatim të nenit 67 të K.Zgjedhor, ka depozituar pranë KSHZ- së, listat e kandidatëve të koalicionit, lista këto që janë miratuar me vendimin nr.167, datë 18.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për miratimin e listave shumemërore të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK) për zgjedhjet për Kuvendin, të datës 25 Prill 2021”.

6. Pas vendimmarrjeve në lidhje me miratimin e listave shumemërore për të gjitha partitë politike dhe koalicionet që përcaktojnë dhe subjektet zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, KSHZ, në zbatim të neneve 86, 88 dhe 180 të Kodit Zgjedhor dhe udhëzimit nr. 3, datë 16.02.2021 “Për miratimin e aktmarrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe partisë politike që përfiton fondet nga buxheti i shtetit dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, ka marrë vendimin nr.172, datë 23.03.2021 “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”. Në këtë vendim, KSHZ ka vlerësuar se sipas lidhjes 2 të vendimit të KQZ-së nr.965 datë 10.08.2015 “Për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015” dhe lidhjes 2 të vendimit nr.555, datë 26.07.2017 “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017”, partitë politike që kanë përfituar jo më pak se 1 për qind të votave dhe që përfitojnë nga ndarja e shumës paradhënie të akorduar nga buxheti i shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore në zgjedhjet e datës 25 Prill 2021, janë si më poshtë:

1. Partia Socialiste e Shqipërisë 764, 750 vota 48.34% = 55,826,750 lekë;
2. Partia Demokratike 456,413 vota 28.85% = 33,318,149 leke;
3. Lëvizja Socialiste për Integrim 259,934 vota 16.69% = 18,975,182 lekë;
4. Bindja Demokratike 20,350 vota 2.67% = 1,485,550 lekë;
5. Partia Social Demokrate 22,320 vota 1.43% = 1,629,360 lekë;
6. Partia Republikane 53,784 vota 3.44% = 3,926,232 lekë;
7. Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar 19,644 vota 1.26% = 1,434,012 lekë;
8. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 76,069 vota 4.81% = 5,552,885 lekë;
9. Partia Fryma e Re Demokratike 29,984 vota 1.92% = 2,188,832 lekë;
10. Partia Demokristiane e Shqipërisë 20,271 vota 1.30% 1,479,742 lekë;

7. Me vendimin nr.172, datë 23.03.2021, KSHZ ka vendosur të shpërndajë si paradhënie, fondet e vëna në dispozicion nga Buxheti i Shtetit partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi (si me sipër).

8. Koalicioni “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës – Konservatorët” (ABEOK), duke mos qënë dakord me fondet e shpërndara paradhënie për partite politike, të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, sipas vendimit të sipërcituar ka paraqitur ankesë pranë KAS, duke pretenduar se:

i) Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar në ligj dhe në K.Zgjedhor, nuk financon nga fondet e buxhetit të shtetit partitë politike pjesë e koalicionit ABEOK;

ii) Nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk është marrë parasysh vendimi i KQZ me nr.555, datë 26.07.2017, vendim i cili ka shpallur rezultatet për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 Qershor 2017;

iii) Shuma që përfiton secila parti sipas nenit 19, pika 2, gërma “a” të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, përcaktohet në këtë mënyrë: shumës prej 98 milionë lekë e cila përbën 70% të shumës totale për tu shpërndarë prej 140 milionë lekësh, i shtohet edhe shuma prej 345,800 lekë, e cila mbetet pa u shpërndarë nga 10% i shumës totale. Totali prej 98,345,800 lekë pjesëtohet me numrin e deputetëve të Parlamentit shqiptar prej 140 deputetësh. Rezultatit 702,470 lekë është shuma që përfiton partia politike për çdo deputet që ka në Kuvend.

9. KAS ka vlerësuar se ndihma financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike dhe fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore (për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje) janë dy institute të ndryshme të financimit të partive politike nga Buxheti i Shtetit. Fondi që përbën ndihmën financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike parashikohet dhe rregullohet nga ligji nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar dhe neni 19 në pikat 2 dhe 3 të tij, rregullon mënyrën e ndarjes së tij. Në lidhje me këtë fond të përvitshëm, për vitin 2021, KSHZ ka marrë vendimin nr.24, datë 02.02.2021 “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2021”, sipas të cilit fondi prej 140,000,000 lekë është ndarë si më poshtë vijon: 1. Partia Socialiste e Shqipërisë 63,417,047 lekë; 2. Partia Demokratike 38,911,877 lekë; 3. Lëvizja Socialiste për Integrim 20,012,797 lekë; 4. Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet 7,447,477 lekë; 5. Lista e Barabartë 4,841,667 lekë; 6. Partia Socialdemokrate 5,369,137 lekë. Ndaj këtij vendimi nuk ka paraqitur ankim asnjë prej partive politike përbërëse të koalicionit ABEOK. Fondi që jepet paradhënie nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje, parashikohet dhe rregullohet nga Kodi Zgjedhor, nenet 88 dhe 89 të tij, që përcaktojnë masën e këtij fondi dhe mënyrën e ndarjes së tij. Përgjashtimisht, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, zbatohet edhe neni 180 të Kodit Zgjedhor, si dispozitë tranzitore për këto zgjedhje. Vendimi nr.172, datë 23.03.2021 i KSHZ-së, i cili ka ndarë fondin prej 13 milionë lekë si fond nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje, i referohet pikërisht këtyre dispozitave të Kodit Zgjedhor.

10. KAS ka vlerësuar se referuar kritereve ligjore të parashikuara në nenet 88, 89 dhe 180 të Kodit Zgjedhor, partitë politike pjesëmarrëse në Koalicionin ABEOK nuk plotësojnë kriteret për

të përfituar nga fondi i dhënë nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje. Në këto rrethana me vendimin nr.13, datë 30.03.2021, KAS ka vendosur:

1. Rrëzimin e kërkesës ankimore nr.07, datë 25.03.2021 të subjektit zgjedhor Koalicioni Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK). 2. Lënien në fuqi të vendimit nr. 172, datë 23.03.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahet si paradhënie partive politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021”.

11. Në këto kushte, më datë 02.04.2021, partitë pjesëmarrëse të Koalicionit Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni - Ora e Shpresës dhe Konservatorët (ABEOK), i janë drejtuar Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor me padinë në objekt gjykimi duke kundërshtuar vendimin nr.172, datë 23.03.2021 të KSHZ si dhe vendimit nr.13, datë 30.03.2021 të KAS.

12. Pala paditëse pretendoi si më poshtë:

- Buxheti i KQZ-së përbën zë më vetë në Buxhetin e Shtetit. Në buxhetin e vitit kur do të zhvillohen zgjedhje, Kuvendi vë në dispozicion të KQZ-së dhe të institucioneve të tjera përkatëse fondet për përgatitjen, zhvillimin, mbikëqyrjen, si dhe çdo aspekt tjetër të procesit zgjedhor. Në rastin kur viti buxhetor nuk është vit zgjedhor, KQZ-së i vihen në dispozicion fonde të mjaftueshme për funksionimin e këtij institucioni, si dhe për ushtrimin e përgjegjësisë së tij sipas ligjit.
- Në rastin konkret koalicioni ka 4 deputet me mandat që kanë qënë pjesë e listës të Partisë Demokratike, e cila në shkurt të vitit 2019 dorëzoi mandatet e fituara në Kuvend sipas zgjedhjeve qendrore të vitit 2017. Në Kuvendin e Shqipërisë rezultojnë kryetarët e partive politike, pjesë e koalicionit kanë pasur mandat deputeti, konkretisht: Partia Kombëtare Konservatore Albania ka Kryetar Deputetin z. Kujtim Gjuzi, Partia Ora e Shqipërisë ka Kryetar deputetin z. Zef Shtjefni, Partia Emigracioni Shqiptar ka Kryetar deputetin z. Kostaq Papa, Partia Bashkimi Popullor i Pensionistëve të Shqipërisë ka Kryetar deputetin z. Selami Jenishehri. Së bashku 4 (katër) kryetarët e partive politike, të cilët kanë mandat në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, kanë regjistruar në KQZ Koalicionin “Aleanca Bashkimi Popullor – Emigracioni – Ora e Shpresës – Konservatorët” (ABEOK)
- Nga KSHZ nuk është marrë parasysh Vendimi i KQZ nr.555, datë 26.07.2017, vendim i cili ka shpallur rezultatet për zgjedhjet e kuvendit të datës 25 qershor 2017.
- Shuma që përfiton secila parti sipas nenit 19, pika 2(dy), germa “a” të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike” i ndryshuar, përcaktohet në mënyrë të tillë që shuma prej 98 milionë leke, e cila përbën 70% të shumës totale për t’u shpërndarë prej 140 milionë lekësh, i shtohet edhe shuma prej 345.800 lekë, e cila ngelet pa u shpërndarë nga 10% e shumës totale. Totali prej 98.345.800 lekë pjesëtohet me numrin e deputetëve të parlamentit shqiptar 140 deputet. Rezultati, shuma prej 702.470 lekë është shuma që partia përfiton për çdo deputet që ka në parlament.

- Mosdhënia e financimit nga Fondi i Buxhetit Shtetëror për partitë e Koalicionit “ABEOK” është diskriminues. Fondet janë trajtuar në mënyrë selektive. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përjashtuar në mënyrë të padrejtë partitë e Koalicionit duke shkelur dispozitat e nenit 86/a dhe nenit 87/4 të Kodin Zgjedhor.
- Fakti që përfitues nga fondet e buxhetit të shtetit të zgjedhjeve në 25 prill 2021, është subjekti Bindja Demokratike, duhet të shërbejë si precedent dhe edhe për partitë e Koalicionit politik “ABEOK”.
- Subjekti politik Partia Ora e Shqipërisë, në vitin 2015, ka përfituar fond nga buxheti i shtetit për të cilën Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ka respektuar dispozitat ligjore të Kodit Zgjedhor përkatësisht nenet 180/1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 ndryshuar me ligjet nr.74/2012, datë 19.07.2012, dhe nr.118/2020, datë 05.10.2020. Në vitin 2019 për zgjedhjet e qeverisjes vendore, subjekti politik Partia Ora e Shqipërisë dhe subjekti politik Partia Emigracion Shqiptar kanë qënë pjesëmarrës për zgjedhjet në koalicion me 6 parti politike, të cilët kanë marrë 10.000 vota, ndërsa subjekti partia Kombëtare Konservatore Albania ka garuar më vete për zgjedhjet e qeverisjes lokale të 30 Qershorit 2019.
- Aktualisht rezulton se partitë politike pjesëmarrëse në Koalicion janë me mandat në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe çdo mandat përlllogaritët me shumën përkatëse 702.470 lekë. Kjo është shuma që partia merr për çdo deputet që ka në parlament edhe pse këta deputetë kanë ardhur nga lista e subjektit politik PD, parti të cilat e gëzojnë këtë të drejtë për tu financuar nga buxheti shtetëror pranë KQZ.

13. Pala e paditur, Komisioni Qëndror i Zgjedhjeve pretendoi si më poshtë:

- Në lidhje me fondin që përbën ndihmën financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike, ky fond rregullohet nga ligji nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” i ndryshuar, neni 19 pikat 2 dhe 3 të tij. Në lidhje me këtë fond të përvitshëm, për vitin 2021, KSHZ ka marrë vendimin nr.24, datë 02.02.2021 “Për shpërndarjen e fondeve vjetore partive politike në formën e ndihmës financiare vjetore për vitin 2021”, për të cilin nuk ka paraqitur ankim ndonjë prej partive politike përbërëse të koalicionit ABEOK.
- Në lidhje me fondet e dhëna paradhënie nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje, ky fond rregullohet nga Kodi Zgjedhor, nenet 88 dhe 89 të tij, që përcaktojnë masën e këtij fondi dhe mënyrën e ndarjes së tij. Përjashtimisht, për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021, zbatohet edhe neni 180 i Kodit Zgjedhor si dispozitë tranzitore për këto zgjedhje.
- Vendimmarrja e KSHZ-së objekt ankimi, nuk ka dalë në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” të ndryshuar, por në zbatim të neneve 88 dhe 180 të Kodit Zgjedhor. Pra kemi të bëjmë me premisa të ndryshme vendimmarrjesh që për rrjedhojë janë fonde dhe formula të ndryshme përlllogaritjeje.
- Sipas Lidhjes 2 të vendimit nr. 965, datë 10.08.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të

datës 21 Qershor 2015”, nga partitë politike që janë pjesë e koalicionit ABEOK, subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore të vitit 2015 kanë qenë vetëm Partia Ora e Shqipërisë dhe Partia Konservatore, të cilat respektivisht kanë marrë 10,754 (0.69%) dhe 7,357 (0.47%) vota në shkallë vendi.

- Sipas Lidhjes 2 të vendimit nr. 555, datë 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017”, asnjë nga partitë politike që janë pjesë e koalicionit ABEOK nuk ka qenë subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2017.
- Sipas dokumentit shkresor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me titull “Zgjedhjet Vendore 2019 – Të dhënat për Votat e Vlefshme për Kandidatët për Këshill në Rang Vendi”, nga partitë politike që janë pjesë e koalicionit ABEOK, vetëm Partia Emigracionit Shqiptar është subjekt zgjedhor që plotëson në mënyrë kumulative kushtet që mos ketë qenë pjesëmarrës në zgjedhjet e viteve 2015 dhe 2017, por të ketë qenë subjekt zgjedhor në zgjedhjet e vitit 2019. Në këto zgjedhje kjo parti ka marrë në rang kombëtar 192 (0.03%) vota.
- Partia Ora e Shqipërisë nuk i plotëson këto kushte në mënyrë kumulative, pasi ka qenë subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet vendore të vitit 2015, por nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2017. Ky subjekt zgjedhor ka qenë pjesëmarrës në zgjedhjet vendore të vitit 2019 dhe ka marrë 3377 (0.44%) vota në shkallë vendi.
- Asnjë nga partitë politike pjesë e koalicionit ABEOK, pavarësisht pjesëmarrjes në ndonjë apo nga disa prej zgjedhjeve të viteve 2015, 2017 apo 2019, asnjëherë nuk ka mundur të plotësojë kushtin për të “... marrë jo më pak se 1 për qind të votave në shkallë vendi ...”. Është pikërisht ky shkak që partive politike pjesë të koalicionit ABEOK nuk i jep të drejtën për të përfituar financim nga Buxheti i Shtetit për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje edhe pse janë pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 Prill 2021.
- Sa i përket analogjisë me Partinë Bindja Demokratike, duke iu referuar dokumentit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me titull “Zgjedhjet Vendore 2019 – Të dhënat për Votat e Vlefshme për Kandidatët për Këshill në Rang Vendi”, rezulton që në zgjedhjet vendore të vitit 2019, Partia Bindja Demokratike ka marrë 20,350 vota (2.67%) në shkallë vendi dhe për rrjedhojë ka plotësuar të tre kushtet kumulative të nenit 180 të Kodit Zgjedhor, pra që nuk ka qenë subjekt zgjedhor në zgjedhjet e viteve 2015 dhe 2017, ka qenë subjekt zgjedhor në zgjedhjet e vitit 2019, si dhe ka marrë jo më pak se 1% të votave në shkallë vendi në këto zgjedhje.

14. Kolegjit Zgjedhor Gjyqësor, pasi shqyrtoi në tërësi pretendimet e palëve arriti në këto konkluzione:

15. Së pari, Kolegji vlerëson se padia e paraqitur nga partitë e Koalicionit plotëson kriteret formale të shqyrtimit të saj.

16. Partitë e Koalicionit legjitimohen për të kundërshtuar vendimet e KQZ (vendimin Nr.13, datë 30.03.2021 të KAS dhe vendimit Nr.172, datë 23.03.2021 të KSHZ-së “Për përcaktimin e sasisë së fondit nga buxheti i shtetit që do t’u shpërndahen si paradhënie partive politike në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”).

17. Nenet 86 pika “a”, 88 dhe 180 të Kodit Zgjedhor, i japin të drejtë partive politike pjesëmarrëse në zgjedhje të përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, sipas kriterëve të përcaktuara. Fondi i krijuar për këtë qëllim shpërndahet me vendim të KQZ. Mospërfshirja e partive të Koalicionit në listën e partive përfituese të këtij fondi dhe pretendimet e tyre në lidhje me zbatim të gabuar të ligjit për ndarjen e këtij fondi, krijojnë premisat e një interesi të ligjshëm, i cili pretendohet të jetë shkelur nga vendimmarrja e KQZ (Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve). Kolegji vlerëson paraprakisht se palës paditëse i njihet e drejta të ankohet ndaj vendimeve të KQZ-së, që cenojnë interesat e tij të ligjshme (shih nenin 145 të Kodit Zgjedhor).

18. Kolegji konstaton se pretendimet e partive të Koalicionit i janë nënshtruar rrugës së shqyrtimit administrativ nga Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe kërkesëpadia është paraqitur brenda afatit ligjor pesë ditor të parashikuar nga neni 145, në lidhje me nenin 152.2 të Kodit Zgjedhor.

19. Së dyti, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se ndarja e fondit të vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit për partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021 rregullohet nga nenet 88 dhe 180 të Kodit Zgjedhor dhe jo nga neni 19 i ligjit nr.8580, datë 17.2.2000.

20. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se fondi që përfitojnë nga Buxheti i Shtetit partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore (për financimin e partive pjesëmarrëse në zgjedhje) në zbatim të Kodit Zgjedhor është i ndryshëm nga fondi vjetor që përfitojnë partitë politike nga Buxheti i Shtetit në zbatim të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000 “Për partitë politike” të ndryshuar. Në zbatim të nenit 19 të ligjit nr.8580, datë 17.2.2000, çdo vit në Buxhetin e Shtetit përcaktohet një fond që shërben si ndihmë financiare publike për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike. Ndhimja financiare e parashikuar në Buxhetin e Shtetit në vitet jozgjedhore, si rregull, nuk mund të jetë më e vogël se ndihma e parashikuar në vitin paraardhës. Ndërsa sipas nenit 88 të Kodit Zgjedhor, partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit. Fondi për këtë qëllim përcaktohet me vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit për vitin zgjedhor përkatës. Meqënëse janë dy fonde të natyrave të ndryshme, për secilin prej tyre ligji ka parashikuar kriteret dhe mënyrën e ndarjes. Në këtë këndvështrim, mënyra e ndarjes së fondit që përfitojnë partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje nuk mund të bëhet duke iu referuar kriterëve të përcaktuara për ndarjen e ndihmës financiare publike që përfitohet për kryerjen e veprimtarisë vjetore të partive politike.

21. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson se fondi që përfitojnë nga Buxheti i Shtetit partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore ndahet sipas kriterit të numrit të votave të përfituar nga partitë politike dhe nuk ndahet dukë iu referuar numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare. Për ndarjen e fondit që përfitojnë nga Buxheti i Shtetit partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore, Kodi Zgjedhor parashikon se KQZ-ja përcakton me vendim vlerën në para të një vote të vlefshme dhe më pas përlllogarit shumën që i takon secilës parti (neni 88 i Kodit Zgjedhor).

22. Kolegji Zgjedhor Gjyqësor vlerëson të gabuar pretendimin e palës paditëse që fondi që përfitojnë nga Buxheti i Shtetit partitë politike të regjistruara si subjekte zgjedhore sipas kodit Zgjedhor duhet të ndahet referuar numrit të deputetëve të fituar në zgjedhjet e fundit parlamentare nga secila parti (neni 19 i ligjit nr.8580, datë 17.2.2000). Kolegji vlerëson se ky kriter shërben për ndarjen e ndihmës financiare publike që përfitojnë partitë politike për kryerjen e veprimtarisë vjetore politike.

23. Së treti, Kolegji vlerëson se asnjë nga partitë politike pjesëmarrëse në Koalicion nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 88 dhe 180 të Kodit Zgjedhor.

24. Konform nenit 88 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se: *“1. Partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhje dhe që kanë marrë jo më pak se 1 për qind të votave në shkallë vendi në zgjedhjet më të afërta pararendëse të të njëjtit lloj, përfitojnë fonde nga Buxheti i Shtetit, në bazë të numrit të votave që secila parti ka marrë në ato zgjedhje. Fondi për këtë qëllim përcaktohet me vendim të Kuvendit dhe përbën zë më vete në Buxhetin e Shtetit për vitin zgjedhor përkatës. Ky fond nuk mund të jetë më pak sesa totali i shumave të shpërndara partive politike në zgjedhjet pararendëse.”*

25. Konform nenit 180 të Kodit Zgjedhor përcaktohet se: *“1. Zbatimi i nenit 88 të këtij ligji për financimin e fushatës zgjedhore për zgjedhjet e para të përgjithshme pas hyrjes në fuqi të tij bëhet duke kryer përlllogaritjet në bazë të rezultatit të zgjedhjeve në shkallë vendi për zgjedhjet vendore të vitit 2015 dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017. 2. Për secilën parti përfshihet në përlllogaritje shifra që pasqyron numrin më të lartë të votave që partia ka marrë në njërën nga këto dy zgjedhje, kur ajo është jo më e vogël se 1 për qind e votave të vlefshme në zgjedhjet përkatëse. Në përlllogaritje përfshihet edhe rezultati i subjekteve zgjedhore, që nuk kanë marrë pjesë në ato zgjedhje, por që kanë marrë pjesë në zgjedhjet vijuese dhe që plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 88 të këtij ligji për kufirin prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara prej tyre.”*

26. Duke iu referuar dispozitave të mësipërme, Kolegji vlerëson se partitë politike duhet të plotësojnë këto kritere, në mënyrë që të përfshihen në ndarjen e fondit: 1) duhet të jenë pjesëmarrës si në zgjedhjet vendore të vitit 2015 ashtu dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017; 2) nëse nuk ka marrë pjesë në të dy zgjedhjet e mësipërme, atëherë duhet të ketë marrë

pjesë në zgjedhjet vijuese, ato të vitit 2019 dhe që plotësojnë kushtin e përcaktuar në nenin 88 të këtij ligji për kufirin prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara.

27. Duke iu referuar partive politike pjesëmarrëse në Koalicion, asnjëra prej tyre nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenet 88 dhe 180 të Kodit Zgjedhor.

28. Sipas Lidhjes 2 të vendimit nr. 965, datë 10.08.2015 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 21 Qershor 2015”, nga partitë politike që janë pjesë e koalicionit ABEOK, subjekte zgjedhore pjesëmarrëse në zgjedhjet vendore të vitit 2015 kanë qenë vetëm Partia Ora e Shqipërisë dhe Partia Konservatore, të cilat respektivisht kanë marrë 10,754 (0.69%) dhe 7,357 (0.47%) vota në shkallë vendi. Sipas Lidhjes 2 të vendimit nr. 555, datë 26.07.2017 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për shpalljen e rezultatit përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 Qershor 2017”, asnjë nga partitë politike që janë pjesë e koalicionit ABEOK nuk ka qenë subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për Kuvend të vitit 2017. Sa më sipër, asnjë nga partitë e Koalicionit nuk plotësojnë kriterin që të kenë qenë pjesëmarrës si në zgjedhjet vendore të vitit 2015 ashtu dhe për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2017.

29. Sipas dokumentit shkresor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me titull “Zgjedhjet Vendore 2019 – Të dhënat për Votat e Vlefshme për Kandidatët për Këshill në Rang Vendi”, nga partitë politike që janë pjesë e koalicionit ABEOK, Partia Emigracionit Shqiptar qënë subjekt zgjedhor në zgjedhjet e vitit 2019, por ka marrë në rang kombëtar 192 (0.03%) vota. Partia Ora e Shqipërisë ka qenë subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet vendore të vitit 2015 por nuk ka marrë pjesë në zgjedhjet e vitit 2017. Ky subjekt zgjedhor ka qenë pjesëmarrës në zgjedhjet vendore të vitit 2019 dhe ka marrë 3377 (0.44%) vota në shkallë vendi.

30. Sa më sipër, asnjë nga subjektet e mësipërme nuk plotëson kriterin që të ketë marrë pjesë në zgjedhjet vijuese, ato të vitit 2019 dhe të ketë kaluar kufirin prej 1 për qind të votave të vlefshme të fituara.

31. Së katërti, Kolegji e gjen të paargumentuar pretendimin e palës paditëse se meqënëse përfitues nga fondet e buxhetit të shtetit të zgjedhjeve në 25 prill 2021, është subjekti Bindja Demokratike, kjo duhet të shërbejë si precedent edhe për partitë e Koalicionit politik “ABEOK”.

32. Kolegji vlerëson se pala paditëse nuk mund të pretendojë që të përfitojë fonde nga Buxheti i Shtetit duke iu referuar analogjisë me një subjekt tjetër. Kolegji vlerëson se fondet nga Buxheti i Shtetit ndahen duke iu referuar kriterëve ligjore dhe jo duke duke iu referuar analogjisë me një subjekt tjetër.

33. Duke iu referuar rastit të Partisë Bindja Demokratike, sipas dokumentit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me titull “Zgjedhjet Vendore 2019 – Të dhënat për Votat e Vlefshme për

Kandidatët për Këshill në Rang Vendi”, rezulton që në zgjedhjet vendore të vitit 2019, kjo parti ka marrë 20,350 vota (2.67%) në shkallë vendi dhe për rrjedhojë ka plotësuar kriteret e nenit 180 të Kodit Zgjedhor, duke qenë subjekt zgjedhor në zgjedhjet e vitit 2019, si dhe ka marrë jo më pak se 1% të votave në shkallë vendi në këto zgjedhje.

34. Në përfundim të kësaj analize, Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, vlerëson se vendimi Nr.13, datë 30.03.2021 i Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve dhe vendimi Nr.172, datë 23.03.2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve janë të mbështetur në ligj, të bazuar në një cilësim të drejtë të fakteve, në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

35. Si konkluzion, pretendimet e palës paditëse kundër vendimit të organeve të KQZ-së për mospërfshirjen në subjektet përfituese të fondit të buxhetit të shtetit për zgjedhjet e Kuvendit të datës 25 prill 2021, vlerësohen të pabazuara në ligj, ndaj edhe kërkimi për ndryshimin e këtyre vendimeve nuk pranohet.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Zgjedhor Gjyqësor, bazuar në nenin 158, pika 3 të Kodit Zgjedhor

V E N D O S I

- Rrëzimin e kërkesë padisë.
- Ky vendim është i formës së prerë dhe ndaj tij nuk lejohet ankim.

U shpall në Tiranë, në datë 08.04.2021.

GJYQTARE

GJYQTARE

GJYQTAR

Emona MUÇI

Manjola XHAXHO

Gentian MEDJA

GJYQTARE

GJYQTAR

Esmeralda ÇEKA (XHILI)

Edlira PETRI

